



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr.544/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjorë Besart Ademi, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Ilias Gërvalla, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që janë mbajtur, më datë 14 Shkurt 2021, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 03.03.2021, mori këtë:

## **V E N D I M**

**Hudhet i palejuar apeli** A.nr 544/2021, i datës 02.03.2021, i parashtruar nga Ilias Gërvalla, për mos konfirmim nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që janë mbajtur më datë 14 Shkurt 2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 03.03.2021.

## **A r s y e t i m**

Me datë 02.03.2021, PZAP-i ka pranuar një apel të parashtruar nga Ilias Gërvalla të dorëzuar nëpërmjet postës me datën 03.02.2021, me të cilin thekson se edhe pse është lajmëruar nga KQZ-ja me datën 20.01.2021, i njëjti thekson se nuk ka pranuar nga ky institucion dokumentet për të votuar. Parashtruesi i apelit kërkon që ai të futet në listën e votuesve jashtë shtetit pasi që dëshiron të votoj.

Paneli pasi që shqyrtoj lejueshmërinë e apelit gjeti se:

### **Apeli është e palejuar**

Paneli, pasi që konstatoj lejueshmërinë e apelit, gjeti se apeli i parashtruar, është i palejuar për arsye se parashtruesi i ankesës nuk ka paraqitur ndonjë vendim të KQZ-së, me të cilën ju është refuzuar aplikacioni për tu regjistruar në listën e votuesve jashtë Kosovës.

Paneli ka parasysh faktin se në rastin konkret nuk ekziston një vendim i KQZ-së, me të cilin do të mund të konstatohej se parashtruesi i apelit është larguar nga lista e votuesve, andaj paneli ka parasysh se bazat e Apeleve zgjedhore ndaj vendimeve të KQZ-së, në PZAP, janë

përcaktuar me nenin 122 paragrafi 1 pikat: a) b) c) d) e) dhe f) të LZP-së, në të cilat përcaktohet se:

- **a)** Përfshirjen ose largimin e një personi për të marr pjesë në programin votues brenda dhe jashtë Kosovës;
- **b)** Certifikimin ose kundërshtimin për të certifikuar një subjekt politik ose kandidat për të marrë pjesë në zgjedhje;
- **c)** Kandidati i cili pas certifikimit nuk dëshiron të marrë pjesë në zgjedhje;
- **d)** akreditimin ose refuzimin për akreditim të një vëzhguesi zgjedhor;
- **e)** vendosjen e një gjobe administrative ndaj një subjekti politik sipas nenit 42 të këtij ligji dhe
- **f)** Refuzimin për të regjistruar një parti politike brenda Zyrës.

Andaj mbi këtë bazë Paneli vlerëson se apeli është e palejuar, nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me nenin 118 të LZP-së dhe nenin 11 paragrafi 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 544/2021 më datën 03.03.2021

**Kryesues i Panelit**

**Adnan Konushevi**



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.